



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. ____ . Prot
____ / ____ /2018

Datë

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për Shoqërinë: “SHPRESA- AL”, sh.p.k me NIPT K31321021N me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr. 11, Kati 2.

Procedura e Prokurimit: “Kërkesë për Propozim” punë.

Numri i Referencës se procedurës/lotit REF-94767-11-19-2018

Përshkrim i shkurtër i Kontratës: “Sistemim asfaltim rruga Dedaj fshati Barbullush NJAD Bushat” me fond limit: **2.408.370,00** (dy milion e katërqind e tetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa T.V.SH, me afat kohor për ekzekutimin: 20 ditë kalendarike

Burimi i Financimit: “Të ardhurat e veta + Transfertë “

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 30.11.2018 ora 10:00

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 47 datë 26.11.2018

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë procedure vetem ky ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik:** “SHPRESA- AL”, sh.p.k me NIPT K31321021N me adrese: Tirane , Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr. 11, Kati 2. Ku ka paraqitur ofertën me vlerë: **2.397.570** (dy milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh, ose **2.877.084** (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e katër) lekë me tvsh.
2. **Operatori ekonomik:** “SARK” shpk me numer nipti K52531415H, me adresë në Fier , Lagjia 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier, Rajoni ne. 3, Përballë supermarket Lalaj. Ku ka paraqitur ofertën me vlerë: **2.007.650** lekë pa TVSH (dy milion e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) ose **2.409.180** (dy milion e katërqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë me tvsh.

❖ **Eshtë Skualifikuar operatori ekonomik :**

1. **“SARK” shpk Arsyet e skualifikimit:**

Nuk ka paraqitur dokumentet e mëposhtme të kërkuara sipas Dokumenteve Standarte të

Tenderit:

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të çertifikuara nga organet tatimore, si dhe raportet e ekspertit kontabel për keto vite. *Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këto dokument).*

- Mungojnë raportet e ekspertit kontabël për keto vite!

2.3 Per kapacitetin teknik

4.Bazuar në Ligjin Nr.10237 datë 18/02/2010 “ Per sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar, nëni 23 si dhe vendimin Nr.312, datë 05.05.2010 “Per miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, ankesi V, VKM nr.742 datë 06.11.2003, duhet që Operatori ekonomik të ketë të punësuar **Mjekun e shoqërisë dhe një ekspert MKZ-je , e vertetuar kjo me:** Të jete në listpagesat e paraqitura nga operatori, Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, Diplome.

- Pasi “Bazuar në ankesin V, VKM nr.742 datë 06.11.2003, duhet që Operatori ekonomik të ketë të punësuar Mjekun e shoqërisë dhe një ekspert MKZ-je , e vertetuar kjo me: Të jetë në listpagesat e paraqitura nga operatori, Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, Diplomë”,

7.Numri mesatar i punonjësve të operatorit ekonomik ofertues të siguruar për periudhën **Janar-Tetor 2018**, të jetë jo më i vogël se 25 punonjës, i vertetuar nga organet tatimore. Të shoqërohen me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve.

-Listëpagesat e periudhës Qershor-gusht 2018 nuk janë konfirmuar nga Drejtoria e Tatimeve.

5.Disponimi i mjeteve të mëposhtme pronesi/qera:

- | | |
|--|--------------|
| • Mjete Transporti, vetëshkarkues mbi 10 Ton | 2 (tre) cope |
| • Autovinc | 1 (nje) cope |
| • Kamionçine 1,5 t - 5t | 1 (nje) cope |
| • Fadrome | 1 (nje) cope |
| • Eskavator me zinxhir | 1 (nje) cope |
| • Autobetoniere | 1 (nje) cope |
| • Gjenerator me fuqi mbi 150 kv | 1 (nje) cope |
| • Autobot uji | 1 (nje) cope |
| • Rrul vibrues hekur-gome 20 Ton | 1 (nje) cope |

Pasi Mjetet duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj.

Per pajisjen Gjenerator me fuqi 150 kv operatori nuk e ploteson këtë kriter pasi fatura tatimore e paraqitur nuk specifikon fuqinë e gjeneratorit.

Shtojmë se fatura tatimore nuk i ploteson kriteret sipas ligjit 9920 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), “elementet e fatures tatimore” duke lënë dyshimin se kjo faturë tatimore me nr. 54 date 21.03.2010 me palë shitëse shoqerine “Arni” shpk mund të jetë e falsifikuar me qellime kualifikimi nga ana e operatorit ekonomik Sark shpk, duke rënë ndesh me ligjin 9643/2006 (i ndryshuar), neni 13 “Perdorimi i dokumenteve te rreme me qellime kualifikimi çon ne perjashtimin e operatoreve ekonomike 1-3 vjet nga prokurimet publike”.

Për sa më sipër ju skualifikoheni nga kjo proçedurë prokurimi!

3. Duke iu referuar proçedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin SHPRESA- AL”, sh.p.k me NIPT K31321021N me adrese: Tirane , Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr. 11, Kati 2, me ofertën me vlerë: **2.397.570** (dy milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh, ose **2.877.084** (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e katër) lekë me tvsh., **është identifikuar si oferta e sukseshme** Rrjedhimisht, jeni i lutur te paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejes, qyteti Vau Dejes sigurimin e Kontrates, siç parashikohet ne dokumentat e tenderit, brenda (30 diteve) nga dita e marrjes se këtij njoftimi.

Ne rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, tenderi do te anulohet si pasojë e mospasjes së një subjekti tjetër të suksesshëm, ne bazë të ligjit nr 9643, date 20.11.2007 ” Per Prokurimin Publik, i ndryshuar”, neni 24, pika ç..

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 07.12.2018.

Ankesa :Ska

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

ZEF HILA